



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

REPUBLIKA E KOSOVES * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 719/24 Dt. 20.11.2024



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M Për formimin e Komisionit

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për formimin e Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve në kuadër të thirrjes për shfrytëzimin e shtëpizave të drurit në projektin: “Dimri Kulturor”. Anëtarë të këtij Komisioni, emërohen:
 - 1.1. Ymer Berisha,.....kryesues,
 - 1.2. Adelina Hoxhaj,anëtar,
 - 1.3. Sherife Çengaj,.....anëtar.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga pika 1 e këtij Vendimi janë: të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha aplikacionet në kuadër të thirrjes për shfrytëzimin e shtëpizave të drurit në projektin: “Dimri Kulturor”, konform thirrjes publike për aplikim, nr. 12-332-147499 të datës 07.11.2024. Komisioni pas shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve të përshkruar si në pikën 1 dhe 2 të këtij Vendimi, të vendos dhe përcaktoj fituesit e thirrjes publike.
3. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
4. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

➤ Vendimi iu dërgohet:

- Të emëruarve,
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
- Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

